

Në bazë të nenit 21,25 të Ligjit Nr. 03/L-87 Për Ndërmarrjet Publike, respektivisht nenit 13 të Ligjit Nr.04/L-111 për ndryshim dhe plotësim të Ligjit Nr. 03/L -87 për Ndërmarrjet Publike. Ligjit Nr.06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike si dhe duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin publik, në bazë të Vendimit të Bordit të Drejtorëve të Kompanisë Rajonale të Ujitjes Radoniqi-Dukagjini Sh.A, me nr. 751 datë 21/07/2023, u vendos që të shpallet:

## KONKURS PUBLIK

Për plotësimin e një pozite:

### 1. Titulli i punës: AUDITOR I BRENDSHËM

Numri i referencës:907

Vendi: Gjakovë

Ndërmarrja: Kompania Rajonale e Ujitjes Radoniqi-Dukagjini Sh.A

I përgjigjet: Komisionit të Auditimit

Kohëzgjatja: 3 vite me mundësi vazhdimi / puna provuese (6) gjashtë muaj në pajtim me Ligjin e Punës.

Niveli i pagës: Sipas Rregullores së brendshme në harmoni me politikat e Kompanisë.

Kompania Rajonale e Ujitjes Radoniqi-Dukagjini Sh.A është Ndërmarrje Publike që në kuadër të veprimtarisë së saj përfshin grumbullimin dhe ofrimin e shërbimit me ujë për ujitjen e tokave bujqësore që shtrihen në perimetrin e sistemit të ujitjes në tri komunat të Gjakovës, Rahovecit dhe Prizrenit.

Bordi i Drejtorëve dëshiron që të gjithë kandidatët potencial të jenë persona me integritet të lartë të cilët i plotësojnë kushtet e kualifikimit sipas Ligjit për Ndërmarrjet Publike si dhe plotësojnë kushtet e pavarësisë dhe kanë përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar për pozitën në fjalë.

### Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:

- Diplomë universitare me sistemin katërvjeçar ose studimet master në Ekonomi, Financa Publike apo fusha tjera të studimeve relevante për sektorin e Auditimit. Diploma pas universitare në këto fusha konsiderohet përparësi;
- Duhet të ketë certifikatë të auditorit të brendshëm në sektorin publik, e lëshuar nga Ministria e Financave ose certifikatë për auditor të brendshëm në sektorin publik nga ndonjë institucion relevant ndërkombëtar apo vendor në pajtueshmëri me kriteret e nxjerra nga Ministria e Financave.
- Kandidati/ja duhet të ketë së paku 3 (tre) vite përvojë në fushën e administrimit të biznesit, financave, kontabilitetit apo nga një fushë tjetër e shkencës ose njohurisë e cila ka të bëjë me veprimtarinë afariste të NP, e preferuar është përvoja në auditim të brendshëm në sektorin publik.
- Të posedojë aftësi të shkëlqyeshme komunikimi dhe organizimi të punës;
- Njohja e punës me kompjuter: Word, Exel dhe Power Point
- Vërtetimi nga Gjykata që nuk është nën hetime (jo me i vjetër se 6 muaj);

- Të ketë aftësi për të interpretuar dhe zbatuar Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe legjislacionin në fuqi që i përgjigjet veprimtarisë së ndërmarrjes.;
- Njohja e gjuhës angleze konsiderohet përparësi;
- Të ketë shkathtësi të prezantimit dhe raportimit;

### **Detyrat dhe përgjegjësitë**

- Vlerëson procesin e veprimeve kontrolluese në tërë ndërmarrjen bazuar në vlerësimin e përshtatshmërisë së sistemeve të kontrollit të brendshëm;
- Respekton legjislacionin e përgjithshëm në fuqi, kodin e etikës dhe sjelljes, si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit;
- Monitoron zbatimin e rekomandimeve në mënyre sistematike sipas planit të veprimit të miratuar nga Udhëheqësi i Ndërmarrjes dhe Komiteti i Auditimit ;
- Vlerëson nëse dizajni i procesit të kontrollit është adekuat, siç është bërë dhe paraqitur nga menaxhmenti;
- Kryen auditime individuale për të siguruar përshtatshmërinë e objektivave dhe fushëveprimit të auditimit, përshtatshmërinë e testimit të kryer dhe saktësinë e konkluzioneve të arritura ;
- Përcakton nëpërmjet të testimit dhe procedurave tjera, nëse procesi në fakt është duke funksionuar në mënyrë efektive dhe efikase ashtu siç është synuar;
- Raporton rezultatet e punës së kryer të auditimit dhe ofron rekomandime aty ku ka nevojë për përmirësimin e procesit të kontrollit;
- Raporton rregullisht tek komiteti i Auditimit dhe përmbush çfarëdo detyre tjetër të përcaktuar nga ana e tyre;

### **Procedura për aplikim:**

Aplikacioni mund të tërhiqet në Web faqe <https://kruradoniqi-dukagjini.com/> apo në selinë e KRU Radoniqi-Dukagjini Sh.A që gjendet në Gjakovë rruga e UÇK-së. p.n dhe të njëjtit i bashkëngjiten dokumentet në vijim:

- Një C.V. e detajuar
- Kopja e dokumentit identifikues
- Letër motivimi (maksimum 500 fjale)
- Dëshmitë e përgatitjes profesionale e noterizuar
- Dëshmitë e përvojës së punës në poste menaxheriale (dëshmia e përvojës së punës bëhet nëpërmjet:
  - Kontratave apo vërtetimet e punës të lëshuara nga punëdhënësit mbi marrëdhënien e punës dhe
  - Pasqyra e kontributeve pensionale
- Tri (3) referenca nga punëdhënësit paraprak
- Deklarata nën betim sipas neneve 17.1 dhe 17.2 të Ligjit për Ndërmarrje Publike
- Certifikatë nga gjykata kompetente që nuk është subjekt i një hetimi për kryerje të veprës penale, nuk është në procedure penale dhe nuk është dënuar nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një vepre penale, jo më e vjetër se 6 (gjashtë) muaj.

Dokumentacioni i kompletuar dorëzohet në zarf të mbyllur në adresën zyrtare Objekti administrativ KRU Radoniqi-Dukagjini Sh.A që gjendet në Gjakovë rruga e UÇK-së. p.n. Konkursi mbetet i hapur tridhjetë(30) ditë kalendarike, afati i fundit për aplikim është data 27/09/2023 deri në ora 16:00.

Vërejtje: Kandidatët me dokumentacion të pakompletuar, të paplotësuar dhe pas afatit të konkurrimit do të refuzohen. Do të kontaktohen vetëm kandidatet të cilët i plotësojnë kushtet e përcaktuara dhe të përfshirë në listën e ngushtë.